

Mesazhet kryesore për mikrobiologët klinikë

Detyrat

1. Detyrat tuaja lidhur me përmirësimin e përdorimit të antibiotikëve përfshijnë [31,98-100] [konsensusi i ekspertëve]:
 - a) Pjesëmarrjen në ekipin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve (kujdestaria e antibiotikëve), si një anëtar kyç i ekipit;
 - b) Bashkëpunimin me specialistin e sëmundjeve infektive dhe farmacistin e spitalit për të zbatuar programin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve;
 - c) Mbështetjen e udhëzuesve të bazuar në dëshmi për përdorimin e antibiotikëve në spital për infeksionet e zakonshme dhe për profilaksinë kirurgjikale;
 - d) Identifikimin dhe raportimin e mikroorganizmave (p.sh. në kulturat e gjakut) në kohë të duhur dhe testimi i ndjeshmërisë antimikrobike;
 - e) Komunikimin e menjëhershëm të rezultateve kritike te mjeku kurues;
 - f) Paraqitjen e të dhënave në një mënyrë që mbështet përdorimin e kujdesshëm të antibiotikëve, për shembull duke raportuar në mënyrë selektive te mjekët një numër të kufizuar rezultatesh për ndjeshmërinë antimikrobike;
 - g) Sigurimin e udhëzimeve për mbledhjen e përshtatshme të mostrave, zbatimin e kritereve të refuzimit për mostrat që nuk janë marrë në mënyrë korrekte dhe përcaktimin e procedurave për të kufizuar përpunimin e mostrave të kontaminuara***** (p.sh. kulturat e gjakut);
 - h) Udhëzimin e terapisë empirike me antibiotikë, duke siguruar të dhëna kumulative të ndjeshmërisë antimikrobike specifike për spitalin dhe repartin (p.sh. njësia e kujdesit intensiv ose departamenti i urgjencës);
 - i) Identifikimin e trendeve kritike lidhur me rezistencën ndaj antibiotikëve në spital dhe komunikimin e menjëhershëm të vërejtjeve me ekipin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve dhe ekipin e kontrollit të infeksioneve.
 - j) Menaxhimin e formularit antimikrobik në spitalin tuaj (d.m.th., lista e ilaçeve të disponueshme për përshkruesit).

Gjërat që mund t'i bëni ose në të cilat mund të bashkëpunoni

2. Jepni udhëzime lidhur me mbledhjen, ruajtjen dhe transportin e mostrave [98,99].

3. Sigurohuni që testimi laboratorik dhe raportimi i ndjeshmërisë antimikrobike të ndjekin udhëzimet e trajtimit (përfshirë raportimin selektiv) dhe të përfshijnë komentet përkatëse mbi interpretimin nëse është e nevojshme [31].
4. Sigurohuni që rezultatet e identifikimit dhe testimit të ndjeshmërisë antimikrobike t'u komunikohen përshkruesve, infermierëve dhe ekipit të administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve, sidomos në rast të rezultateve kritike (p.sh. kulturat e gjakut) [98-100].
5. Sigurohuni që testimi dhe raportimi i rezultateve mikrobiologjike të ndjekin standardet evropiane dhe kombëtare (p.sh. Komiteti Evropian për Testimin e Ndjeshmërisë Antimikrobike - EUCAST) [31].
6. Siguroni të dhëna për rezistencën ndaj antibiotikëve në nivel spitali dhe reparti dhe komunikoni trendet ekipit të administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve dhe ekipit të parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve [101].
7. Trajtoni përshkruesit në spital rregullisht për rezistencën ndaj antibiotikëve dhe për përdorimin e testeve diagnostikuese të shpejta dhe në pikën e kujdesit mjekësor [31,53].